

20180641182

LIGJ PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT PËR VEPRIMTARI INOVATIVE

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari inovative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/13, 137/13, 41/14, 44/15, 6/16, 53/16 dhe 190/16) në nenin 32 paragrafin (6) në pikën 4) pikëpresja zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Në pikën 5) në alinenë 4 lidhëza "ose" zëvendësohet me presje.

Në alinenë 5 lidhëza "dhe" zëvendësohet me lidhëzën "ose" dhe shtohet aline e re 6 si vijon:
"-APTIS (APTIS)- së paku niveli B2 (B2).".

Pika 6) shlyhet.

Neni 2

Dispozitat e nenit 32 paragrafi (6) pika 5) të Ligjit për veprimtari Inovative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/13, 137/13, 41/14, 44/15, 6/16, 53/16 dhe 190 / 16) dhe dispozitat e nenit 1 të këtij ligji, me të cilin plotësohet neni 32 paragrafi (6) pika 5) me aline të re 6, nuk do të zbatohet nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Neni 3

Drejtori i zgjedhur në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018 është i detyruar të plotësojë kërkesën për njohjen e gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes së tij.

Drejtorit, i cili nuk do të plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni i pushon mandati.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".